



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME DETARE

Nr. 1800/14 Prot

Durrës 05 / 08 / 2022

VENDIM

NR. 4 DATË 05.08.2022

MBI PEZULLIMIN E QËNDRËS TRAJNUESE ACA Albania

Bazuar në memon nr1409/1 prot e datës 04/08/2022 nga kryetari i komisionit “Të testimit teorik dhe praktik për pajisjen me dëshmi aftësie për mjete të vogla lundruese” dhe akteve të konstatimit të grupit të punës sipas Planit të punës së miratuar me nr prot 1406 prot datë 02.08.2022, vihem në dijeni për problematikat e konstatuara gjatë inspektimeve në qëndren e trajnimit **ACA Albania**, me administrator znj. Sonila Osmani

Qendra e trajnimit **ACA Albania**, me administrator znj. Sonila Osmani, Nga verifikimi në listat e kandidatëve nuk disponohet firma për çdo kandidat të cilët janë deklaruar se kanë përfunduar trajnimin dhe janë prezantuar shkresërisht nëpërmjet “Lista e kursantëve për testim” si kandidatë të gatshëm për testim pranë Drejtorisë së Përgjithshme Detare. Gjithashtu nga verifikimi I Regjistrit të amzës, në të cilin u evidentua se mungon firma e kandidatëve, gjithashtu kandidatët nuk kanë firmosur as në “Listën e kursantëve”.

Në formularin “Njoftim mbi fillimin e trajnimit” nr.28 Prot, datë 31.07.2022, njofton se me datë 29.07.2022 aplikantët e shenuar në shkresën njoftim aplikantët kanë filluar kursin e trajnimit, në kundërshtim me formularin e njoftimit trajnuesi i qendrës deklaroi se qendra është e mbyllur dhe se personeli është me pushime dhe nuk janë zhvilluar kurse trajnimi, fakt që bie në kundërshtim me deklarinimin e tyre në njoftim e datës 31.07.2022 se personat e deklaruar në njoftim kishin filluar kursin me datë 27.07.2022.

Qendra e trajnimit **ACA Albania**, në mënyrë të përsëritur ka shkelur Udhëzimin nr. 2 të Ministrit, Ndaj qendrës ACA Albani është marrë 1 (një) masë administrative. Me Vendimin nr prot 2183/8 datë 29.12.2021, “Paralamërim për pezullim aktiviteti” nga Drejtoria e Përgjithshme Detare.

Për keto arsye në bazë të ligjit nr.10109 i datës 02.04.2009 “Për administratës Detare” si dhe pikës c, nenit 32 të Udhëzimit të Ministrit Nr.2, datë 05.05.2021, për “Kriteret e Kualifikimit dhe

Kategoritë e Drejtimit të Mjeteve Lundruese në Republikën e Shqipërisë”, pasi kjo qëndër trajnimi ka marrë 1 (një) masa administrative;

VENDOSA

Për qendrën e trajnimit **ACA Albania**, pezullim i aktivitetit të trajnimit për 3 (tre) muaj.

1. Qendrën e trajnimit **ACA Albania** do jetë e pezulluar të ushtrojë aktivitetin e saj nga periodha 05.08.2022 deri më 05.11.2022
2. Ngarkohet Komisioni i testimit teorik dhe praktik për pajisjen me dëshmi aftësie për mjete të vogla lundruese” për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi sot me datë 05/08/2022
4. Subjekti **ACA Albania** ka të drejtën e ankimit të këtij vendimi në organet kompetente brenda afateve të parashikuara nga Kodi i procedurave Administrative.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

PAVLIN NDREU

NË MUNGESË DHE ME URDHËR

ZV/DREJTOR I PËRGJITHSHËM & KAPITEN I PORTEVE

TOMOR HARIZI

